



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE ASETETEVE
SEKTORI I ASISTENCËS LIGJORE KONTRATAVE DHE ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Vau Dejës, _____.2025

Nr ____ Prot

PROJEKT-VENDIM

Nr. 5 Datë. 7.10 2025

"Për plotësimin e Vendimit Nr.38, datë 24.05.2024 të Këshillit Bashkiak me Certifikatë Pronësie me Nr. Pasurie 685/4, Zk.3506"

Mbështetur në nenin 9 pika 1.2 germa "a", nenit 27 pika 5, nenit 54 germa "e/I", nenit 55 pika 3, nenit 64 germa "c" të ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; nenin 25 të ligjit Nr.57/2020, datë 30.04.2020 "Për Pyjet", i ndryshuar; pikën 49, shtojca 47, të VKM-së nr.433 datë 08.06.2016, "Për transferimin në pronësi të bashkive pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarëve dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive", i ndryshuar; Kreun III pika 6 të VKM-së nr.748, datë 01.12.2022 "Për përcaktimin e zonës, distancës dhe gjerësisë së brigjeve të burimeve ujore", shtojcën nr.1 pika 8 të VKM-së nr.559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjorë kombëtarë, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusorë Pyjorë"; VKB-në Vau Dejës nr.7, datë 26.01.2024 Mbi miratimin e listës së ngastrave/në ngastrave pyjore të gatshme për dhënie në përdorim"; Udhëzimin nr.1 datë 09.06. 2016 të Ministrit të Mjedisit "për Rregullat e procedurat e kerkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjorë dhe kullor publik", i propozojmë Këshillit Bashkiakë Vau Dejës, ku në mbledhjen e datës _____.2025 të :

VENDOSI:

1. Të miratojë plotësimin e Vendimit Nr.38, datë 24.05.2024 të Këshillit Bashkiak me Certifikatë Pronësie me Nr. Pasurie 685/4, Zk.3506.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6 të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.


KRYETARI

Kristian Shkreli

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/KRYETAR

Aleksandra Gjoni





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE ASETIVE
SEKTORI I ASISTENCËS LIGJORE KONTRATAVE DHE ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Nr. ____ Prot

Vau Dejës, ____ . ____ .2025

Lënda: "Për miratimin e plotësimit të Vendimit Nr.38, datë 24.05.2024 të Këshillit Bashkiak me Certifikatë Pronësie me Nr. Pasurie 685/4, Zk.3506"

Të nderuar Anëtarë të Këshillit të Bashkisë

Para Këshillit të **Bashkisë Vau i Dejës**

Administrimi i fondit pyjor dhe kullosor në territorin e Bashkisë Vau Dejës, është një ndër funksionet e Bashkisë, i përcaktuar në nenin 27 pika 5 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", përcaktohet:

"Funksionet e Bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit: Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve: pika 5 administrimin e fondit pyjor dhe kullosor publik, sipas legjislacionit në fuqi."

Ligji bazë mbi të cilin kryhet administrimi i fondit pyjor është ligji nr. 57/2020 "Për pyjet" i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Bazuar në nenin 9 pika 1.2 germa "a", nenit 54 germa "e/l", nenit 55 pika 3, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, është kompetencë e Këshillit të Bashkisë, dhënia me qira të tretëve të pronave të Bashkisë. Sipërfaqja e fondit pyjor që kërkohet të jepet në përdorim është 10.246 ha. Kjo sipërfaqe do t'i nënshtrohet procedurës së konkurrimit publik sipas legjislacionit në fuqi.

Procedura e ndjekur është në zbatim të Udhëzimit nr. 1, datë 09.06.2016 të Ministrit të Mjedisit "Për Rregullat e procedurat e kërimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik".

Sa më sipër ju bëjmë me dije se pronësia për dhënien në përdorim me afat deri ne 10 vjet të sipërfaqes pyjore prej 10.246 ha, Për park fotovoltaiik (stacionet, objektet përkatëse etj.) në

ekonomitë pyjore Drin Gjadër Kirë është bërë Projekt-Vendimi Nr.18, datë 24.04.2024 dhe marrë Vendimi Nr.38, datë 24.05.2024 “Për dhënien në përdorim me afat deri në 10 vjet të sipërfaqes pyjore prej 10.246 ha, Për park fotovoltaik (stacionet, objektet përkatëse etj.) në ekonomitë pyjore Drin Gjadër Kirë” për shkak të një gabimi që është bërë nga zyra përkatëse për ngarkesën e Certifikatës së pronësisë në Projekt-Vendimin Nr.18, datë 24.04.2024 në këto kushte kërkojmë “Miratimin e plotësimit të Vendimit Nr.38, datë 24.05.2024 të Këshillit Bashkiak me Certifikatë Pronësie me Nr. Pasurie 685/4, Zk.3506”.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë dokumentacionin e plotë.

Ju faleminderit!

KRYETARI

Kristian Shkreli

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/KRYETAR

Aleksandra Gjoni





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË PËR VËRTETIM PRONËSIE

371100

Zyra e Regjistrimit SHKODËR Zona Kadastrale Nr. 3506
Numri i Pasurisë 685/4 Volumi 6 Faqe 142
Adresa e Pasurisë SHKODËR - STAN KË
Lloji i Pasurisë KULLOTË
Sipërfaqja Totale 453 496 m² (KATËRGJIND E PESE DHJETË E TREHISE
E KATËRGJIND E NENTËDHJETË E QOKTË)
Nga kjo : Sa Truall - Nga kjo : Sa Ndërtesa -
Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes - %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
<u>"KOMUNA BUSHAT"</u>				<u>BUSHAT</u>
				<u>SHKODËR</u>

- është pronar i PASURISË ME NR. 685/4
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart -
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi -
- kufizimet e pasurisë janë : V 685/4 , L 685/4 , J 685/4 , P 823/8

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me
Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të
Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së
paraqitur nga i (të) interesuari (t)
më datë 04.11.2010 Nr. 131

JUHSTE V. RECAJ
Data e lëshimit të çertifikatës

04.11.2010

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI

(NERITAN KALAMISHI)

Z.V.R.P.P.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Shkodër, më 06.12.2024

Nr. 384/3 Prot.

Lënda: Mbi Vendimin Nr. 38, datë 24.05.2024 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 9, pika 1.2, shkronja "a", neni 27, pika 5, neni 54, shkronja "e/l", neni 55, pika 3 dhe 4, të ligjit nr. 57/2020 "Për pyjet", neni 25, të ligjit 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të VKM nr. 696, datë 30.10.2019 "Për përcaktimin e kufijve territorialë, hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe të qendrës e përbërjes së këshillit të secilit prej tyre", të VKM nr. 748, datë 1.12.2022 "Për përcaktimin e zonës, distancës dhe gjerësisë së brigjeve të burimeve ujore", pika 6, të VKM nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive", të ndryshuar, pika 49, shtojca 47, ka në trajtim VKB Vau Dejës nr. 38, datë 24.05.2024 "Për dhënien në përdorim me afat deri në 10 vjet të sipërfaqes pyjore prej 10.246 ha, për park fotovoltai (stacionet, objektet perkatese), në ekonomisë pyjore Drin Gjadër Kir. në ngastrat 12, 13, 14".

Për trajtim të mëtejshëm, Prefekti i Qarkut Shkodër në rolin edhe si Kryetar i Këshillit të Basenit Ujor Drin Bunë, i është drejtuar Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor Drin Bunë me anë të shkresës nr.384/1 prot., datë 31.05.2024, për tu shprehur nëse sipërfaqja e propozuar për dhënie në përdorim, e cituar si më sipër, përfshihen në basen dhe nuk bie ndesh me dispozitat e ligjit nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar. Me anë të shkresës së ZABU nr. 231/1 prot., datë 27.11.2024 "Kthim përgjigje kërkesës për trajtim" ka vlerësuar së përdorimi i sipërfaqes së propozuar për dhënie në përdorim nuk bie ndesh me përcaktimet e legjislacionit për burimet ujore, sipas ligjit nr. 29/2024 "Për burimet ujore", por afatet e parashikuara sipas VKM nr. 867/2014 "Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore", janë tejkaluar nga ana e ZABU.

Për sa trajtuar, Prefekti në zbatim të kompetencave të përcaktuara nga Urdhëri i Ministrit të Brendshëm nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", Aneksi I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", neni 4, pika 1, shkronja "b", kërkon plotësimin e vendimarrjes me statusin juridik të pronës. Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

